

V E N D I M
Nr. 3. datë 5.1.2002

PËR STRUKTURËN E KOMITETIT KOMBËTAR TË DIGAVE TË MËDHA (KKDM)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 dhe 13 të ligjit nr.8681, datë 2.11.2000, “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) të përbëhet nga 15 anëtarë, të cilët emërohen nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Turizmit.

Sekretar i KKDM-së është sekretari i Sekretariatit Kombëtar të Digave të Mëdha (SKDM).

2. Pranë KKDM-së, si organ këshillimor, funksionon Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave (KTPD), i cili përbëhet nga 7 anëtarë, që emërohen nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Turizmit.

3. Anëtarëve të KKDM-së dhe KTPD-së u jepet një shpërblim mujor për veprimtarinë e tyre, i barabartë me 30 për qind të pagës së drejtorit të drejtorisë në ministri.

4. Mjediset e punës për KKDM-në dhe strukturat e tjera të parashikuara me ligj sigurohen nga Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit.

5. Shpenzimet dhe pagat të përballohen nga buxheti i miratuar, për çdo vit, për Ministrinë e Punëve Publike dhe Turizmit.

6. Vendimet nr.444, datë 3.9.1993 “Për krijimin e Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha”, nr.485, datë 3.9.1993 “Për miratimin e Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha”, nr.73, datë 22.1.1996 “Për krijimin e Këshillit Teknik të Përhershëm të Digave” të Këshillit të Ministrave, dhe ndryshimet e tyre me vendimet nr.181, datë 18.3.1996, nr.749, datë 11.11.1996, nr.286, datë 18.6.1999 të Këshillit të Ministrave dhe çdo akt nënligjor që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

7. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta